



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:064084
Datë: 28.08.2024
Numri i dokumentit: 06096840

A.nr.985/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Valbona Gjonbalaj, në konfliktin administrativ të paditëses H.B. nga P..., të cilën me autorizim e përfaqëson avokat ..., kundër të paditurës Ministria e Financave Punës dhe Transfereve- Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile (DFDILVC), për shkak të anulimit vendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur, në mungesë të palëve ndërgjyqëse, me datë 09.07.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar, kërkesëpadija e paditëses ..., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurës, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - DFDILVC, me numër 01-02/7198, i datës 16.07.2019 dhe ti njihet e drejta në pension të skemës Invalid Civil të Luftës.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (më tutje LKA), në mungesë të palëve ndërgjyqëse.

Paditësja me datë 08.06.2020 ka ushtruar padi në gjykatë për anulimin e vendimit të paditurës Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - DFDILVC, me numër 01-02/7198, i datës 16.07.2019 dhe ti njihet e drejta në pension të skemës Invalid Civil të Luftës dhe ti atë në shkallën e invaliditetit 40 %.

Përfaqësuesi i paditëses në seancën e datës 11.05.2023, ka deklaruar se mbetem pranë padisë dhe ekrkesëpadiisë duke pasur parasysh gjendjen faktiek të paditëses e njëjta konsideron se nga gjendja aktuale shëndetsore e arrinë invaliditetin në shkallë prej 40 % ashti sic përkufizohet me ligj dh enë bazë të dokuemntacionit mjekësor I propozojë gjykatës që të nxjerret ekspertizë mjekësore nga QKUK me të cilën do të përkufizohet me saktësi shkallën e invaliditetit të paditëses. Më tej ka theksuar se sa I përket pranimi të vendimit në zarfin e dorëzuar me padi shifet data kur e kemi pranuar vendimi me që rast dihet që ankesa është parashtruar brenda afatit ligjor. Ndërsa në seancën e datës 28.08.2023 përfaqësusi sipas autorizimit zëvendësues ka bërë rregullimin e padisë në aspektin subjektiv ndaj palës së paditurë Ministria e Financave Punës dhe Transfereve. Dhe ka bërë precizimin e pëtitimit të padisë dhe ka kërkuar anulimin e vendimit numër 01-027198, tëdatës 16.07.2019 dhe paditëses ti njihet e drejta në pensionin invalidor civil të luftës të përcaktuar në shtojcën e ligjit Nr.04/L-054dhe atë nga data e paraqitjes së kërkesës e deri në ditën e marrjes së aktgjykimit dhe pas këtij derisa te kezistojnë ksuhtet ligjore. Më tek ka theksaur se nuk është kontestuese se paditësja ka statusin e invalidit civil të luftës por

kontestuese është shkalla e invaliditetit të saj. Me qëllim të vërtetimit të sakt sa i përket shkallës së invaliditetit propozojmë gjykatës që të lejohet ekzaminimi mjekësor me ekspertizë mjekësore nga tre mjekë të lëmisë ortoped tramautolog, psikiatër dhe kirurk plastic.

E paditura nëpërmes përgjegjës në padi të dorëzuar në gjykatë ka theksuar: Këshilli i Ankesave për Pensione pranë Departamentit të Pensioneve, për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit të lëndës ka refuzuar kërkesën e paditëses pasi nuk i plotëson kushtet ligjore sipas ligjit për shkallën e invaliditetit prej 40 % .Vendimi është i ligjshëm në konstatim të drejtë të gjendjes faktike dhe me asnjë dokument të sjellur nga paditësja dhe as nga komisioni mjekësor nuk ka konstatim të shakllës tjetër përveç shkallës prej 20 % . Prandaj e paditura i propozon gjykatës që të hudhet posht kërkesëpadinë e paditëses si e pabazuar .

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor-publik, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vërtetimi nga Klinika e Kirurgjisë plastike edt,22.01.2018; vërtetimi nga Trupat Mbrojtëse numër 01/481 i dt.17.05.2002; vendimi i dt.16.07.2019; Ankesa e paditëses e dt.19.02.2019; vendimi i dt.11.01.2019; Formulari për aplikim i dt.29.12.2010; Formulari për invalid i dt.25.03.2011; Ankesa e dt.31.01.2012; Rivlerësimi nga Komisioni mjekësor i dt.18.12.2018; Vërtetimi i dt.28.12.2010; Dëshmia e cila është pa datë, e dhënë nga ...; Dokumentacioni mjekësor i dt.28.09.1999; Udhëzimi mjekësor specialist nga Klinika e Fiziatriisë e dt.08.04.2002; Udhëzimi i dt.21.06.2022; 08.04.2002; vendimi i dt.13.03.2012; vendimi i dt.21.04.2011; 11.05.2012; udhëzimi për konsulte 09.06.2023, 28.06.2023; Raporti mjekësor i dt.23.11.2023; Raporti me EMG i dt.23.11.2023; Ekspertiza Mjekësore.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar.

Me vendimin me numer. 01-02/7198 i datës 11.01.2019, gjykata gjeti se paditura ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e këtu paditëses, me të cilin kishte kërkuar që t'i njihet e drejta në penison të skemës: Invalid Civil i luftës, me arsyetimin se te ankuesja është konfirmuar shkalla e invaliditetit prej 20%.

Me Venidmin 01-02/7198 i datës 16.07.2019, gjykata gjeti se paditura ka hedh posht si të paafatshme akeseën e paditëses, me të cilin kishte kërkuar që t'i njihet e drejta në penison të skemës: Invalid Civil i luftës, ndërsa në arsyetimin ka kontaktuar ankesa është refuzuar sepse është vepruar në bazë të nenit 5 dhe nenit 14 të Ligjit Nr.04/L-054.

Gjykata vlerësoi pretendimet e të paditurës të konstatuara në vendim sa i përket afatshmërisë së ankesës dhe gjykata gjeti se ankesa kundër vendimit të datës 11.01.2019 është e parashtruar brenda afatit ligjor tek e paditura, referuar fletëpranimit të postës ku shifet që në dy vulat janë të shënuar datat 23.01.2019 dhe tjetra datë nuk shifet por muaji po 02.2019, ndërsa e shkruar me shkrim dhe nënshkruar me datën 15.02.2029 dhe konstatoi se që të tri datat janë brenda afatit 30 ditë nga dita kur është parashtruar ankesa 19.02.2019. E që në rastin konkret pretendimet e palës së paditur sa i përket afatshmërisë nuk i mori për bazë dhe parashtrimin e ankesës e konsideroi brenda afatit ligjor. Po ashtu e paditura në përgjigjen në padi nuk i është referuar fare afatshmërisë së parashtrimit të ankesës por ka theksuar se *“pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit të lëndës ka refuzuar kërkesën e paditëses pasi nuk i plotëson kushtet ligjore*

sipas ligjit për shkallën e invaliditetit prej 40 % .Vendimi është i ligjshëm në konstatim të drejtë të gjendjes faktike dhe me asnjë dokument të sjellur nga paditësja dhe as nga komisioni mjekësor nuk ka konstatim të shkallës tjetër përveç shkallës prej 20 % . Prandaj e paditura i propozon gjykatës që të hudhet posht kërkesëpadinë e paditëses si e pabazuar”.

Andaj me qëllim të vendosjes meritorë në këtë çështje juridike administrative gjykata ka caktuar marrjen e provës me ekspertizë mjekësore për dhënien e mendimit profesional në përbërje të Dr. ... -Ortoped, Dr. ...- Kirurg plastik dhe Dr. ... - psikiatër. Ekspertët mjekësor kanë dhënë mendimin profesional ku nga vlerësimi i ortopedit është konstatuar se krahu i majte është me kufizim të lëvizjes në nivel të njëjës humeroskapulare dhe muskulatura dic me dobësuar krahasuar me krahun e djathtë. Në vlerësimin e kirurgjisë është konstatuar se vërehen cikatrikse në regjionin e krahut të djathtë , të cilat janë si pasojë e plagëve me armë zjarri që janë me madhësi 1 cm në pjesën e sipërme të krahut të djathtë.. Ndërsa në vlerësimin psikiatrik është konstatuar se bazuar në dokumentacionin e disponuar paditësja është trajtuar nga psikiatri Dr. ... sipas raportit të datës 03.09.2012ka diagnozën Çrregullim i stresit post traumatik, ndërsa sa i përket statusit mendor ftesës i përgjigjet pa hezitim. Pamja i përgjigjet moshës kronologjike, kujdesi për vetën i ruajtur, veshje adekuate. Kontakti me sy është intermitent, të folurit me ton të ulët, përgjigjet në pyetjet e parashtruara adekuate. Disponimi i ulur afekti kongrunet. Nuk manifestohet ide suicidale. Nuk manifeston çrregullim në të mensuar për nga forma as për nga përmbajtja. Koshient për gjendjen e saj. Ndërsa në vlerësimin e përbashkët kanë dhënë mendimin se në bazë të tabelave mjekësore orientuese për vlerësimin e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në kapitullin 1.2 krahu dhe nyja e krahut pika1.2.2 kontraktura e nyjës së krahut pas lëndimit të strukturave kockore-ligamentoze nen c) në shkallë të rëndë (mbi 2/3) jepet zvogëlim të aktivitetit jetësor me 20% për lëndime e pësura gjatë luftës.

Gjatë shqyrtimit kryesor ekspert mjekësor Dr ... Kirurgu plastik ka dhënë mendimin dhe sqarimin e kërkuar nga gjykata lidhur me detyrat e dhëna konform Aktvendimit A.nr.985/2020 të datës 23.08.2023 i cili ka dhënë mendimin e tij Ne baze te dokumentacionit dhe provave – dokumenteve mjekësore dhe ekzaminimit te drejtpërdrejtë te paditëses nga tre anëtarët e Komisionit ku ne si Komision kemi kërkuar nga paditësja që të na sjell edhe incizimin e nervave te parakrahut EMNG-në të dt.23.11.2023 dhe në bazë të formulës së Baltazarit, kemi dhënë mendimin e përbashkët si Komisioni mjekësor duke konstatuar se ne bazë të tabelave mjekësore orientuese për vlerësimin e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm mjekësor në kapitullin 1.2 Krahu dhe nyja e krahut pika 1.2.2 kontraktura e nyjës se krahut pas lëndimit të strukturave kockore – ligamnetoze nën c) Në shkallë të rëndë mbi 2/3) jepet zvogëlim të aktivitetit jetësor apo me 20% invaliditet për lëndimet e pësura gjatë luftës dhe në bazë të këtij mendimi dhe vlerësimi në emër të Komisionit konziliar mbetem pranë mendimit dhe ekspertizës mjekësore. Ndërsa ekspertja ... përmes parashtrësës së datës 08.07.2024 ka theksuar se qëndron pranë mendimit të dhënë në ekspertizën mjekësore.

Gjykata për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit iu referua Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre neni 14 përcaktohet si dhe me shtojcën e e Ligjit Nr. 04/L-054 Për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre:

“Të drejtat dhe beneficionet e invalidëve civil të luftës:

1. Të drejtën në pensionin invalidor civil të luftës e realizojnë invalidët civil të luftës me shkallë të invaliditetit prej 40%-100%.

2. Me qëllim të realizimit të të drejtave të përcaktuara me këtë ligj, sipas shkallës së invaliditetit, invalidët civil të luftës radhiten në pesë (5) grupe:

2.1. Grupi I - invalidët civil të luftës me 81-100% të shkallës së invaliditetit, të cilëve për jetë të rregullt iu nevojitet përkujdesja dhe ndihma e personit tjetër;

2.2. Grupi II - invalidët civil të luftës me 71%-80% të shkallës së invaliditetit;

2.3. Grupi III - invalidët civil të luftës me 61%-70% të shkallës së invaliditetit;

2.4. Grupi IV - invalidët civil të luftës me 51%-60% të shkallës së invaliditetit;

2.5. Grupi V - invalidët civil të luftës me 40%-50% të shkallës së invaliditetit.

Në bazë të nenit 63 të LKA-së, dispozitat e LPK-së do të zbatohen përshtatshmërisht në rastet kur LKA nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, andaj bazuar në këtë, gjykata iu referua nenit 7.1 të LPK-së, ku përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”.*

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se paditësja pranë kësaj gjykate nuk i ka paraqitur fakte mbi të cilat e mbështet kërkesën e vetë në kuptim që të jetë bindëse lidhur me kërkesën e saj. Provat e ofruara dhe të referuara nuk janë bindëse për të konstatuar se paditësja ka shkallën e invaliditeti më të lartë apo siç është kërkuar në shkallë 40 %, se ajo e përcaktuar me vendimin e të paditurës dhe ekspertizën mjekësore në shkallë ë invaliditetit 20 %. Provat dokumentacioni mjekësor të cilat i referon paditësja nuk janë prova me të cilat dëshmohet një shkallë e invaliditet më e lartë se ajo e përcaktuar me ekspertizën mjekësore, po ashtu të njëjta nuk kanë lidhshmëri me provat tjera të shkresave të lëndës me të cilat dëshmohet përqindje më e lartë e dëmtimit trupor, apo shkallë më e lartë e invaliditetit të këtu paditëses, andaj janë të pamjaftueshëm sepse me të njëjtat nuk është arritur të dëshmohet se këtu paditësja i plotëson kriteret për njohjen e të drejtës së pensionit të skemës invalid civil i luftës më shumë se 20% Andaj edhe pretendimet e paditëses në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor, nuk kishin ndikim, në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura dhe ekspertiza mjekësore e nxjerr gjatë shqyrtimit gjyqësor me të cilën është përcaktuar shkalla e invaliditetit 20 %. Mbi këto arsye, gjykata kërkesëpadinë e paditëses nuk e aprovoi, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata konstaton se në këtë çështje administrative, drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses, andaj pretendimet e paditëses nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur

Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore.

Në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit përfundimtar administrativ.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës, u mor duke u bazuar në nenin 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lartë, gjykata në kuptim të nenit 44, 46.2, lidhur me nenet 5, 6, 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çëshje Administrative
A.nr. 985/2020, datës. 09.07.2024.

Gjyqtarja
Valbona Gjonbalaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.